



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MAT

NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Burrel, më _____._____.2026

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “E HAPUR – PUNË”

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Asfaltim i rrugëve lidhëse në fshatrat e Njësive Administrative Faza II”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45210000-2 Punime ndërtimi.

VLERA E FONDIT LIMIT:

249 984 031.60 (dyqind e dyzet e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e tridhjetë e një pikë gjashtëdhjetë) **lekë pa TVSH, ndarë për vitin 2026 në vlerën:** 49 999 996.67 (dyzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH, nga buxheti i shtetit:** 17 551 997.5 (shtatëmbëdhjetë milion e pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë pikë pesë) **lekë pa TVSH, nga grandit i performancës (financim i huaj):** 7 407 284.17 (shtatë milion e katërqind e shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë e katër pikë shtatëmbëdhjetë) **lekë pa TVSH dhe nga të ardhurat:** 25 040 715 (njëzet e pesë milion e dyzet mijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë) **lekë pa TVSH, për vitin 2027 në vlerën:** 50 721 639.16 (pesëdhjetë milion e shtatëqind e njëzet e një mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë pikë gjashtëmbëdhjetë) **lekë pa TVSH, nga buxheti i shtetit:** 3 854 595.83 (tre milion e tetëqind e pesëdhjetë e katër mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë pikë tetëdhjetë e tre) **lekë pa TVSH dhe nga të ardhurat:** 46 867 043.33 (dyzet e gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyzet e tre pikë tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH, ndërsa për vitin 2028 në vlerën:** 149 262 395.77 (njëqind e dyzet e nëntë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e treqind e nëntëdhjetë e pesë pikë shtatëdhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH, nga buxheti i shtetit:** 95 709 843.34 (nëntëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e nëntë mijë e tetëqind e dyzet e tre pikë tridhjetë e katër) **lekë pa TVSH, dhe nga të ardhurat:** 53 552 552.43 (pesëdhjetë e tre milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy pikë dyzet e tre) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Mat** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1, dhe Listën e Çmimeve (sipas zërave të preventivit) sipas Shtojcës 2;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 100 % e fondit limit të marrëveshjes kuadër që prokurohet.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2026** për adresën/at ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b dhe 3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare**;... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.**”

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, **kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.**”

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. **Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

Ndërsa në **nenin 88** “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera

tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, dhe 2025 lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më pak se 100 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet, dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2023, 2024, 2025) të konfirmuar nga administrata tatimore, pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin që të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij me kushtin që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, vlera e xhiros duhet të përmbushet në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim, ndërsa bilancet duhet të paraqiten nga secili anëtar.

Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se, bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të aktivitetit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përlllogaritur të marrëveshjes kuadër që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se **200%** e fondit limit të marrëveshjes kuadër që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:
- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
 - ii. Situacionin përfundimtar të objektit dhe situacionet progresive/pjesore
 - iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor
 - iv. Aktin e Kolaudimit të objektit
 - v. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit
 - vi. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

- b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:
- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
 - ii. Situacionin përfundimtar të objektit
 - iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor
 - iv. Aktin e Kolaudimit të objektit
 - v. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit
 - vi. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast, respektivisht duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të Operatorëve dhe Prokurën e Posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve që ka marrë përsiper të kryeje secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e nënkontraktimit, kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimin Zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/c dhe 4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Ndërsa në nenin 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t’u vendosur ne DST. Fjala “kërkon” nënkupton se këto kriteret janë kritere detyrues, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërm.

Njësia përcaktoj kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Referuar natyrës së kontratës për punë publike, njësia vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentacionit ligjor të zbatimit të punimeve, bazuar në ligjin Nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), si dhe akteve në zbatim të tij, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b të VKM-së, të paraqesin dhe kontratat e sipërmarrjes, situacionet përfundimtarë, aktin e kolaudimit (*si dhe çertifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve*), për të vërtetuar faktin, nëse operatori ekonomik pjesëmarrës zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës në masën e përcaktuar sipas nenit 39 pika 5 të VKM-së, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të paraqitet dhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre, pasi në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, si dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Duke qënë se paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që A.K., të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (*në rast mungese të informacionit të sipërcituar*), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**
 - **Kategoria NP-1** (*Punime gërmimi në tokë*) – **Klasifikimi A**
 - **Kategoria NP-4** (*Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale*) – **Klasifikimi E**
- **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**
 - **Kategoria NS-6** (*Sinjalistika rrugore jondriçuese*) – **Klasifikimi A**
 - **Kategoria NS-8** (*Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri*) – **Klasifikimi B**

- **Kategoria NS-14** (*Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV*) – **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-18** (*Punime topogjeodezike*) – **Klasifikimi B**

* Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e liçensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- **ISO 9001** (*Për sistemin e menaxhimit të cilësisë*) e përditësuar
- **ISO 14001** (*Për sistemin e menaxhimit të mjedisit*) e përditësuar
- **ISO 45001** (*Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose **ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare**, e përditësuar
- **ISO 39001:2012** (*Çertifikatën e sistemi i menaxhimit të trafikut rrugor*) e përditësuar
- **EN 1090** (*Certifikim per fabrikimin dhe montimin e elementeve prej celiku*) e përditësuar

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave dhe objekti i së cilave duhet të jetë në përputhje me objektin e prokurimit. Nëse çertifikatat janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencën e nevojshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë liçencën – Kodi III.2.B - “Për grumbullim dhe transportim e mbetjeve të ngurta”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), të vlefshme, shoqëruar me Akt - Miratimin e liçencës për administrimin e mbetjeve për tipet me kodet: 17 05 04 dhe 17 05 08.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, liçenca duhet të disponohet nga operatori ekonomik që do të marrë përsipër të realizojë grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, referuar kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi ose me kontratë qeraje/ shërbimi të lidhur me një laborator testimi të materialeve kryesore të ndërtimit beton, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve **SSH EN 12390-3:2019**, **SSH EN 12350-2:2019** dhe **SSH EN 12504-2:2012** e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kontrata me laboratorin e testimit duhet të disponohet nga operatori ekonomik që do të marrë përsipër të realizojë zërat e betonimeve, referuar kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

2.3.6 Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:

- **Tuba të brinjëzuar HDPE SN8** (*Sipas specifikime teknike në projekt*)
- **Bojë Bikoponente** (*Sipas specifikime teknike në projekt*)

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

1. Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave lëshuar/ lidhur jo më parë se data e publikimit të procedurës së prokurimit. Autorizimi/ Marrëveshja bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, dhe të jetë i vlefshëm vetëm për këtë objekt deri në realizimin e plotë të punimeve.

2. Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Shënim: *Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin. Në katalog të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme artikulli/ pajisja që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen dhe specifikimet përkatëse sipas DST.*

3. Operatori Ekonomik për të gjitha materialet e mësipërme duhet të paraqesë Çertifikatë/ Deklaratë konfirmimit CE, Çertifikatat e cilësisë ose Raportet e Testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara në Specifikimet teknike. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.

- *Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.*

Shënim: Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtoria.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/a, 2 dhe 4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **a)**

përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;... c) aftësinë teknike dhe profesionale;...

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në **nenin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 2, 4, 6 dhe 8** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“2. Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës.

4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës;

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Në **nenin 40 pika 6/ b dhe c** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

Gjithashtu në **nenin 44** “Kërkesat e cilësisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) përcaktohet se, citojmë: **“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. 2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.**

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

1. Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (të ndryshuar), neni 8 i tij në të cilin përcaktohet se, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore, dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” në të cilin ndër të tjerash përcaktohet se, subjekte private a publike që kryejnë investime në ndërtime me fonde private ose prokurojnë me fonde publike kanë detyrimin për kontraktim vetëm subjekte të licensuar, sipas kësaj rregulloreje, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë licencën profesionale për zbatimin e punimeve, me **kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlojit të objektit të punimeve, ku sipas preventivit të punimeve OE duhet të disponojnë: kategorinë NP-1 (Punime gjurmimi në tokë)** në lidhje me zërat e punimeve në preventiv (*Gërmim dheu kat I-^{rë} me skreper..., Mbushje me çakëll e gur guroje..., Gërmim dheu me eskavator goma në kanal... etj*); **kategorinë NP-4 (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, ...)** në lidhje me zërat e punimeve në preventiv për trupin e rrugës (*Shtresë stabilizant..., Shtresë çakëlli..., Shtresë binderi..., Shtresë Asfaltbetoni... etj*); **kategorinë NS-6 (Sinjalistika rrugore jondriçuese)** në lidhje me zërat e punimeve të vendosjes së sinjalistikës rrugore (*F.V. Tabela rrugore treguese..., Vijëzim shirita gjatësor dhe anësor..., F.V. Tabela të ndryshme rrugore... etj.*); **Kategoria NS-8 (Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura...)** në lidhje me zërat e punimeve në preventiv (*Struktura monolite betoni C25/30,...*), **Kategoria NS-14 (Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV)** në lidhje me zërat e punimeve në preventiv për vendosjen e ndriçimit rrugor (*F.V. Shtylla metalike për ndriçim, Ndriçues LED, F.V. Kabllo Cu..., F.V. Kuadër komandimi..., F.V. Elektroda tokëzimi... etj.*), si dhe **kategorinë NS-18 (Punime topogjeodezike)** - duke qënë se në projekt – preventivin e zbatimit janë parashikuar punime të natyrës topogjeodezike, është e nevojshme zotërimi dhe i kësaj pike liçense, si dhe **klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë propocionale me objektin e kontratës.**

2. Njësia e prokurimit gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime, ku më hollësisht:

- ISO 9001, është kërkuar me qëllim vërtetimin e efektivitetit dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së operatorit ekonomik, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove, duke bërë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta;
- ISO 14001, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik për marrjen e masave të nevojshme mjedisore ndaj dëmtimit të mjedisit kontrolluar duke minimizuar aq sa lejon sistemi, ku gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis, si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra, ky certifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit;
- ISO 45001, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik në lidhje me vlerësimin e rrezikut dhe përgaditjen e punonjësve duke i ushtruar dhe trajnuar ato me qëllim për të minimizuar/ eliminuar rreziqet të cilat u ekspozohen gjatë kryerjes së punimeve, si një detyrim ligjor, ku veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci shtesë që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.
- ISO 39001, është kërkuar me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje me sistemin e qarkullimit rrugor, si dhe të reduktojë apo përjashtojë rreziqet e humbjes së jetës dhe plagosjeve të rënda në aksidentet e qarkullimit rrugor. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit ku kemi kryerjen e punimeve në rrugë automobilistike nacionale dhe urbane ku mundësia për ngarkesën e trafikut rrugor është e lartë si nga automjetet ashtu dhe nga këmbësorët, me qëllim minimizimin e këtij risku, është e domosdoshme që ofertuesit të jenë të pajisur me këtë certifikim për të shmangur këto pasoja.
- ISO S SH/ EN 1090, është një standart i rëndësishëm dhe kryesor që duhet të disponojnë ofertuesit në këtë objekt prokurimi, pasi ai përcakton standartet europiane që rregullojnë punimet e prodhimit dhe montimit të strukturave prej çeliku që mbajnë markën CE, ku cilësia e produktit/ tabelave rrugore treguese e kërkuar duhet të zbatohet si në procesin e prodhimit, ashtu dhe montimit, ku operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të vërtetojë se zbaton këto standarte, me qëllim garantimin e performancës së sigurisë së materialeve në nivelin më të. Referuar punimeve të sinjalistikës rrugore si dhe rëndësisë së objektit të prokurimit, kërkohet disponimi i këtij standarti. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor si garanci që ofertuesit të vërtetojnë se disponojnë aftësitë e nevojshme për kryerjen e punimeve të sinjalistikës rrugore të një cilësie të mirë dhe të qëndrueshëm, duke shmangur situatat e nevojës për riparimin e difekteve, ku si rrjedhojë do të sillte vonesa në përfundimin dhe vënien në efikasitet të investimit.

3. Referuar preventivit të punimeve, duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve (*dheu, kanale, shkëmb, etj.*), ku grumbullimi i mbetjeve që dalin nga këto gërmime dhe transporti i tyre në venddepozitimet e miratuara, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “*Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte*” **kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B)** sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “*Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë*”, nga institucioni kompetent që lëshon këto licenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “*Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta*”. Referuar natyrës së mbetjeve që mund të dalin gjatë punimeve, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.99, datë 18.02.2005 “*Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të Mbetjeve*”, njësia e prokurimit ka përcaktuar dhe kodet e mbetjeve që duhet të disponojë operatori ekonomik pjesëmarrës në Akt-Miratimin e licencës së kategorisë III.2.B, ku është kërkuar paraqitja dhe e këtij të fundit.
4. Gjithashtu, referuar rëndësisë që ka investimi objekt prokurimi, ku do të kryhen punime të cilat duhet të kenë rezistencën dhe qëndrueshmërinë mekanike, si digat e ujëmbledhësve, kanalet etj., në zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*” (i ndryshuar) neni 4 dhe 14 i tij, **ku sanksionohet ndër të tjerash se në rastet kur materialet e ndërtimit janë prodhuar në vend, duhet të pajisen me certifikatë cilësie nga laboratorë të akredituar**, si dhe Udhëzimit Nr. 2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*” Kreu II pika 3 i tij, në të cilin përcaktohet se, citojmë: “*3. Materialet dhe produktet e ndërtimit me standarde të detyrueshme vendosen në vepër kur janë shoqëruar me certifikatë cilësie, me rezultatet e provave dhe të analizave, që vërtetojnë ose vlerësojnë përputhshmërinë e tyre me standardet, që referohen në përshkrimet dhe specifikimet teknike.*”, **njësia e prokurimit vlerëson t’u kërkojë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës që të disponojnë një kontratë shërbimi të lidhur me një laborator të akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar, për kryerjen e analizave të produkteve që do të vendosen në objektin e prokurimit, si: *Beton i freskët dhe Beton i ngurtësuar sipas standardit***, sipas Listës të standarteve të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.98, datë 06.02.2013 “*Për miratimin e listës së standardeve të harmonizuara shqiptare, që kanë karakter referues për prezumimin e konformitetit për produktet e ndërtimit*” në zbatim të ligjit Nr.9290, datë 07.10.2004 “*Për produktet e ndërtimit*” (i ndryshuar).
5. Po ashtu, njësia e prokurimit bazuar në preventivin e punimeve objekt kontrate, ku përveç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, **ku disa prej tyre duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë një jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë**, vlerëson se operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t’i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/ materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, **me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga A.K., nëse këto materiale/ pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomik pjesëmarrës janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në**

dokumentat e tenderit, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të certifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standarteve të miratuara. Po ashtu, kërkesa për paraqitjen e këtij dokumentacioni i jep besueshmërinë autoritetit kontraktor se operatori ekonomik ka garancinë e furnizimit me këto produkte në sasinë dhe kohën e duhur për realizimin e investimit të veprës objekt prokurimi.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet profesionale e teknike si më lart duke qënë se këto kriteret janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **85 (tetëdhjetë e pesë) punonjës** për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.8 **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:**

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, libreze pune, të figurojnë detyrimisht në listëpagesat e shoqërisë (sipas legjislacionit në fuqi) për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.7, si dhe të jetë i punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, pika 2 e tij, ku përcaktohen papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit, për sa i takon ndalimeve të dypunësimit, stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimuni **2 (dy) Inxhinier Ndërtimi (Profili Transport)**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili Strukturist)**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Elektrik**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

b) Krahas stafit të drejtuesve teknik të kërkuar më lart, operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf ndihmës për kryerjen e punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme), diplomë përkatëse/ Çertifikatë të vlefshme, lëshuar nga institucione të licensuara /akredituara nga institucionet përgjegjëse shtetërore, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.7, stafi ndihmës inxhinierik (jo domosdoeshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Minimuni **1** (një) Inxhinier Hidrogeolog
- Minimuni **1** (një) Inxhinier Auditues/ Inspektues i Sigurise Rrugore
- Minimuni **1** (një) punonjës i çertifikuar si Specialist Për Testimin e Performancës së Materialeve/ Produkteve të Ndërtimit/ Inxhinier Materialelesh;

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

c) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve të preventivit objekt kontrate, duhet të disponojë punonjësit e specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- Teknik i mesëm ndërtimi – jo më pak se **3** (tre) punonjës
- Teknik i mesëm Topograf/ Gjeometër – jo më pak se **2** (dy) punonjës
- Specialist karpentier – jo më pak se **6** (gjashtë) punonjës
- Betonues – jo më pak se **10** (dhjetë) punonjës
- Hekurkthyes – jo më pak se **2** (dy) punonjës
- Elektriçist – jo më pak se **4** (katër) punonjës
- Punëtor asfalti – jo më pak se **18** (tetëmbëdhjetë) punonjës
- Saldator – jo më pak se **2** (dy) punonjës
- Bojaxhi – jo më pak se **2** (dy) punonjës

Krahas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/ privat lëshues i certifikatës/ diplomës	Numri indentifikues i certifikates/ diplomes	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1.					
2.					
etj.					

* Disponimi i stafit/ punonjësve sipas specialitetit të kërkuar, duhet të deklarohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të

njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontrata e punës e vlefshme, Kartelat përkatëse të Sigurimit Teknik (për elektriciçistët), dëshmi/ çertifikatë kualifikimi të lëshuara nga institucione publike/ private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” për specialistët, ndërsa për teknikët duhet të paraqiten diplomat e shkollës së mesme, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.7. Për stafin e specializuar/ kualifikuar të kërkuar në këtë kriter nuk pranohen më shumë se 2 (kualifikime profesionale/ teknike) për një punonjës.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

d) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, dëshmi/ çertifikatë trajnimi të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, diplomat (vetëm për punonjësit inxhinierë të kërkuar), si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.7, punonjës të kualifikuar/ çertifikuar si më poshtë:

- Minimuni **1 (një) punonjës** të disponojë çertifikatë/dëshmi si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë”** në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 237 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.
- Minimuni **1 (një) punonjës** që përmbush kriteret për të qenë **“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”**.
- Minimuni **1 (një) punonjës** që përmbush kriteret për të qenë **“Ekspert Zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim”** në përputhje me Ligjin Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”.

Disponimi i stafit mbështetës do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, ku operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë të dhënat: emër/ mbiemër, titullin e kualifikimi/ çertifikimit, numrin e diplomës/ çertifikatës, datën e lëshimit të saj dhe emrin e organit kualifikues/ çertifikues kompetent, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

e) Operatori ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë inxhinier me përvojë pune dhe i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Librezë pune (përkatëse)
- CV përkatëse
- Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë

- Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Shënim: Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi **6 (gjashtë)** shoferë të mjeteve të rënda (të cilët duhet të disponojnë leje drejtimi me kategorinë “C” dhe/ose “CE” dhe/ose “D” dhe/ose “DE”), dhe **10 (dhjetë)** manovratorë (të cilët të jenë me kualifikimin: **6 (gjashtë) Eskavatoristë dhe 4 (katër) Automakinist**), të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.7 në rastin kur mjetet/makineritë e deklaruar janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**

- Kontratë pune të vlefshme,
- Dëshmi Kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit,
- Dëshmi Kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar).

* Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Deklarata B) operatorët ekonomik pjesëmarrës si dhe operatorët mbështetës të deklaruar nga operatorët pjesëmarrës si subjekt mbështetës duhet të deklarojnë për punonjësit manovratorë të mesipërm të dhënat: *emër/ mbiemër, profilin e punës, numrin e kontratës individuale të punës, numrin e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale dhe afatin e vlefshmërisë së saj.* (të njëjtat të dhëna duhet të deklarohen për punonjësit e kontraktuar edhe kur mjetet/ makineritë disponohen me qira)

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.**

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të

përshatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose entë kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në **nenin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 6/b** dhe **c** dhe **8** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “6. Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/entë kontraktor kërkon:

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;

8. Autoriteti/entë kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Ndërsa në **nenin 88** “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kriteret janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kriteret detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërm.

1. Kriteri i vendosur për disponimin e një punësimi mesatar jo më pak se **85 (tetëdhjetë e pesë) punonjës**, duke përfshirë stafin teknik, punonjësit e specializuar/ certifikuar dhe drejtuesit e mjeteve/makinerive është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së, dhe nenit 39 pika 6/c të VKM-së, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat, natyrën dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, autoriteti kontraktor ka marrë parasysh numrin e punonjësve (stafin teknik, stafin mbështetës dhe specialistët, shofer/ manovrator etj.) që nevojitet për realizimin e objektit sipas kushteve të parashikuara në Shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve teknike” dhe zërave e volumeve të preventivit, koeficientit të njëtrajtshmërisë së fuqisë punëtore dhe kohëzgjatjes së punimeve (afatit të kryerjes së punimeve (18 muaj) të përcaktuar në dokumentat e tenderit, ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të

Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” si dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar), njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentat konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për përmbushjen e këtyre kushteve, dokumenta të cilat nuk përbëjnë kosto shtesë për plotësimin e dokumentacionit nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. Ndërsa në lidhje me periudhën e kërkuar, për të paktën 3 muajt e fundit, njësia e prokurimit në hartimin e këtij kriteri iu është referuar datës së publikimit dhe zhvillimit të kësaj procedure prokurimi, **ku ka vlerësuar të nevojshme që për vërtetimin e bindjes se operatori ekonomik pjesëmarrës ka një qëndrueshmëri dhe besueshmëri në fuqinë punëtore që realisht disponon**, ka kërkuar që ky punësim të disponohet deri në 3 (tre) muaj përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit, kërkesë e cila është e arsyeshme, proporcionale dhe aspak diskriminuese. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomikë, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. **Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.**

2. Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës objekt prokurimi, me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, dhe **vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, pasi mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve njësisia e prokurimit referuar zërave të punimeve që do të kryhen objekt kontrate, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e drejtuesve teknik (inxhinierët) me kualifikimet e kërkuara.** Kërkesa specifike për inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë preventivit të punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik), ku më hollësisht parashatrojmë:
 - Janë kërkuar minimuni 2 (dy) Inxhinier Ndërtimi (Profili Transport), pasi referuar projektit të objekt prokurimit, kemi rehabilitimin dhe asfaltimin e disa rrugëve rurale të njësisive administrative të bashkisë Mat në vendodhje të ndryshme dhe në një distancë larg njëra - tjetrës, ku lind e nevojshme që të angazhohen 2 (dy) inxhinier ndërtimi me profilin e duhur që punimet të zbatohen dhe kontrollohen në mënyrë konkrete nga ana e tyre, pasi punimet (gërmimi, shtresave asfaltike, strukturat monolite etj.) në trupin e rrugëve do të kryhen njëkohësisht në më shumë se 2 (dy) fronte pune, ku të paktën njëri prej inxhinierëve, gjithashtu do të jetë i angazhuar dhe me ndjekjen e dokumentacionit dhe korespondencave në lidhje me objektin e investimit;
 - Gjithashtu, duke qënë se kemi të bëjmë dhe me punime ndërtimi i veprave të artit, si: *F.v Tuba metalik..., F.v Tuba te brinjëzuar HDPE..., Tuba Betoni..., Struktura monolite betoni C 25/30*, është kërkuar që në stafin teknik të disponohet dhe 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, profili Strukturist, pasi referuar specifikës dhe rëndësisë që ka infrastruktura rrugore, ku do të kalojnë mjete të tonazhit të rëndë, veprat e artit si: *urat, mbikalimet etj., (që do të kryhen*

për kalimin e ujërave, përrenjve etj.) lind e domosdoeshme që këto punime të kryhen nën mbikqyerjen e inxhinierit me profilin përkatës (strukturist), me qëllim kontrollin e tyre, vlerësimin dhe marrjen e masat inxhinierike të nevojshme për mënyrën e ndërhyrjes, dhe ndërtimin e strukturave të tyre rezistente, pra, mos të kemi dëmtime si pasojë e kalimit të mjeteve dhe dukurive natyrore për shkak të strukturës së dobët;

- Është kërkuar minimuni 1 (një) Inxhinier Elektrik, pasi ky objekt përmban dhe kryerjen e punimeve të *instalimeve elektrike për ndriçimin rrugor* ku është e nevojshme që këto punime të zbatohen me përgjegjshmëri dhe monitorohen në mënyrë të vazhdueshme nga ana e inxhinierit të fushës;
- Është kërkuar minimuni 1 (një) Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder, pasi do të kryejë azhurnimin topografik dhe piketimin e shtresave asfaltike dhe në bazë të këtij azhurnimi do të llogariten edhe gërmimet, mbushjet sipas devijimeve që merr rruga sipas terrenit si dhe do të ndjekë punimet e zbatimit sipas kuotave të projektit. Gjithashtu pas përfundimit të punimeve do të bejë edhe azhurnimin faktit (as built);

ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 42, datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*.

3. Gjithashtu, referuar natyrës dhe përmasave të kontratës objekt prokurimi, **njësia e prokurimit gjykon se operatorët ekonomikë duhet të disponojnë në stafin e tyre të shoqërisë dhe staf ndihmës të inxhinierëve të kërkuar, për kryerjen e punimeve të cilat janë të parashikuar në preventivin e kontratës**, ku këta inxhinierë jo domosdoeshmërit duhet të jenë drejtues teknik të shoqërisë.

- *Inxhinier Hidrogeolog* - kërkohet prezenca e inxhinjerit hidrogeolog, pasi në zonën ku do të ndërtohen dy nga segmentet e këtij projekti në fjalë është një terren i paqëndrueshëm dhe vazhdimisht i ngopur me ujë, i cili do të krijojë destabilitet në ndërtimin e trupit rrugës si dhe çarjen e strukturës së saj, fakt i cili është theksuar dhe në Relacionin Teknik të projektuesit. Pra, inxhinjeri hidrogeolog është i domosdoeshëm për: - *Menaxhimin e Emergjencave Ujore: Identifikimin e menjëhershëm të thyerjeve hidrogeologjike apo burimeve të reja që shfaqen gjatë gërmimit dhe projektimin e shpejtë të drene-dritareve apo kanaleve devijuese. - Kontrollin e Sistemeve të Drenazhimit: Sigurimin që shtresat filtruese po funksionojnë dhe presioni i poreve po ulet sipas parashikimeve, duke parandaluar "likuidimin" e tokës nën rrugë. Prania e inxhinierit hidrogeolog në fazën e zbatimit është imperativ teknik, pasi ky stad përbën përballjen e parë direkte me paqëndrueshmërinë reale të terrenit ku do ndërtohen këto segmente;*
- *Inxhinier Inxhinier Auditues/Inspektues i Sigurisë Rrugore* është kërkuar referuar natyrës dhe specifikave të punimeve objekt kontrate, duhet për të kontrolluar dhe garantuar sigurinë rrugore, **ku ky inxhinier/ inspektues identifikon rreziqet në ndërtim e rrugës**, merr masa për parandalimin e aksidenteve dhe siguron që projekti të përmbushë standardet dhe kërkesat ligjore të sigurisë, gjë e cila ndihmon në uljen e aksidenteve, mbrojtjen e përdoruesve të rrugës dhe shmangien e kostove të mëvonshme për korrigjime. Disponimi i këtij specialisti është theksuar dhe në Relacionin Teknik të projektuesit, ku si rrjedhojë lind

e nevojshme që punimet e zbatimit të ndiqen edhe nga ky inxhinier/ punonjës me kualifikimin e kërkuar;

- Ndërsa *punonjësi i çertifikuar si specialist për Testimin e Performancës së Materialeve/ Produkteve të Ndërtimit/ Inxhinier Materialeve* vlerësohet si kërkesë e nevojshme, pasi duhet që një punonjës të jetë i specializuar në sigurinë dhe kontrollin e cilësisë në lidhje me punimet që do të kryhen dhe mallrat/materialet që do të furnizohen dhe vendosen në objektin e prokurimit, ku, referuar rëndësisë së veçantë që ka investimi objekt prokurimi, **vlerësohet me rëndësi fakti që të disponohet një punonjës me këto njohuri të posaçme mbi kontrollin e cilësisë, pasi duke qënë prezent gjatë gjithë periudhës së punimeve ai vlerëson, teston dhe kontrollon cilësinë e çdo punimi/ materiali që kryhet dhe vendoset në objekt**, kërkesë kjo e cila i shërben A.K. për vërtetimin se operatori ekonomik jep garanci se punimet objekt prokurimi do të jenë brenda standarteve të kërkuara;

4. Po ashtu, referuar natyrës, dhe përmasave/ volumit të punimeve që përmban objekti i prokurimit, **me qëllim vërtetimin e aftësisë zbatuese të kontratës**, njësia e prokurimit vlerëson se, operatorët ekonomik duhet të disponojnë stafin specialist/ të kualifikuar për kryerjen e të gjitha punimeve objekt prokurimi, si:

- **Teknik i mesëm Ndërtimi** - referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit duke siguruar kështu kontrollin e cilësisë së punime në të gjitha fazat e zbatimit të projektit;
- **Teknik mesëm Topograf/ Gjeometër** - referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit dhe matjeve duke siguruar kështu kontrollin e cilësisë së punime në të gjitha fazat e zbatimit të projektit;

ku krahas dokumentave të tjera të kërkuara, është e rëndësishme që për vërtetimin e aftësive të tyre, të paraqiten diplomat e shkollës së mesme. Gjithashtu krahas teknikëve, referuar natyrës, specifikës dhe volumit të punimeve që do të kryhen, për realizimin e tyre në përputhje me standartet teknike të zbatimit dhe brenda afatit të përcaktuar, njësia e prokurimit vlerëson të nevojshëm disponimin e **punonjësve të kualifikuar, të cilët duhet të jenë me specialitetin:**

- **Specialist karpentier** - bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar punimeve të vendosjes së armaturës për punimet e betonit të kalimeve mbi ujë dhe puseta;
- **Betonues** - referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me eficensë të punimeve të hapjes së betonit dhe procesit të betonimit. Kërkesa për numrin lidhet referuar sasisë dhe grafikut të punimeve dhe faktit që punimet do kryhen në segmente të njëjta për të arritur eficiencën dhe kohën;
- **Hekurkthyes** - referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me eficensë të punimeve të hekurit;
- **Elektriçist** - bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen për punimet elektrike të ndriçimit rrugor etj.

- **Punëtor asfalti** - referuar specifitimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen e punimeve të të shtresave të bitumit dhe asfaltit në trupin e rrugëve;
- **Saldator** - bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar punimeve saldimi të tubave dhe konstruksioneve metalike,
- **Bojaxhi** - bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar punimeve të vijëzimit të rrugëve me shirita gjatësor dhe anësor.

pasi pa këto punonjës të kualifikuar nuk mund të kryhen/ realizohen punimet objekt kontrate prokurimi, ku për vërtetimin e disponimit të tyre është kërkuar plotësimi dhe paraqitja e të dhënave sipas tabelës të përcaktuar, dhe paraqitja e dokumentacionit, dëshmitë/ certifikatat e kualifikimit të lëshuara nga institucione publike/ private të licencuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” për vërtetimin se këto punonjës janë të kualifikuar për kryerjen e punimeve objekt kontrate, si dhe kanë njohuri për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë në lidhje kryerjen e punimeve, përdorimin e mjeteve, marrjen e masave mbrojtëse etj., **në zbatim të Rregullores së Sigurimit teknik për punën në ndërtim**, si dhe të figurojnë të punësuar në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit. Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

5. Referuar natyrës së punimeve që do të kryhen, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të disponojnë në stafin e tyre personelin e kualifikuar/ certifikuar:
 - Në lidhje me kërkesën për disponimin si pjesë të stafit të punësuar 1 (një) punonjësi që disponon certifikatë/dëshmi si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, njësia e prokurimit vlerëson se, kjo kërkesë është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi ky inxhinier i certifikuar **nevojitet për përshtatjen e kantierit sipas fazave të punimeve, mbajtjen e kantierit në kushte të rregullta, kontrollin e materialeve dhe pajisjeve të punës me qëllim eliminimin e defekteve që mund të dëmtojnë sigurinë dhe/ ose shëndetin e punëmarrësve, si dhe verifikimin e zbatimit të planit të sigurisë dhe koordinimit gjatë zbatimit të punimeve** kërkesa kjo në zbatim të nenit 9 dhe 10 të ligjit të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, dhe nenit 2, 5 dhe 10 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”.
 - Kërkesa për disponimin e 1 (një) punonjësi që përmbush kriteret për të qenë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, është një kërkesë në përputhje me natyrën e punimeve, dhe vendodhjes së punimeve, ku njësia e prokurimit vlerëson se, bazuar në parashikimet e nenit 23 të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe pikës 13 të Pjesës A “Kërkesa minimale me karakter të përgjithshëm për vendet e punës në kantier” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.312, 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, është i nevojshëm disponimi nga operatorët ekonomikë i **punonjësit** të certifikuar si “Ekspert për Ndihmën e Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”, **me qëllim instruktimin e punonjësve dhe dhënien e ndihmës së parë në rast rrezikimi të jetës së punonjësve të angazhuar në kryerjen e punimeve objekt kontrate.**

- Në lidhje me kërkesën për disponimin e 1 (një) Ekspert zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, të pajisur me çertifikatën përkatëse lëshuar nga MZSH, njësia e prokurimit vlerëson se, kjo kërkesë është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi stafi operacional i operatorit ekonomik duhet të jetë i trajnuar për çdo rast emergjence, ku ndër to janë edhe rastet e zjarrit, kërkesë kjo bazuar në parashikimet e nenit 38 të Ligjit Nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, **në të cilin përcaktohet se, personat fizikë dhe juridikë zbatojnë dispozitat e parashikuara nga ky ligj dhe akte të tjera nënligjore, në lidhje me marrjen e masave për parandalimin e pakësimin e zjarreve, me anë të mjeteve, sistemeve, pajisjeve të diktim-sinjalizimit për shuarjen e zjarreve, gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre.**
6. Po ashtu, me qëllim kryerjen e punimeve ndërtimore objekt kontratës sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimeve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë, duke qënë se vlera e preventivuar për punimet që do të kryhen është mbi 30,000,000 milion, në zbatim të Udhëzimit Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” njësia e prokurimit vlerëson që operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, **i cili duhet të jetë i përfshirë në liçensimin e shoqërisë, si dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryen punimet në objekt**, kjo dhe në rastin kur ofertuesi merr pjesë si bashkim i operatorëve ekonomik, secili anëtar duhet të përcaktojë/ deklarojë drejtuesin teknik të punimeve, si dhe të paraqesë dokumentacionin e kërkuar.
 7. Gjithashtu, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet që të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar për disponimin në stafin e tyre, e të paktën **6 (gjashtë)** shoferë të mjeteve të rënda (të cilët duhet të disponojnë leje drejtimi me kategorinë “C” dhe/ose “CE” dhe/ose “D” dhe/ose “DE”), për përdorimin e automjeteve: *Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton, Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton, Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton, Autovinç deri në 5 ton, Autobetoniere, Autobitumatrice, Autobot uji, dhe 10 (dhjetë) manovratorë (të cilët të jenë me kualifikimin: 6 (gjashtë) Eskavatoristë dhe 4 (katër) Automakinist),* për përdorimin e automjeteve/ mjeteve: *Eskavator, Fadromë me goma me targa, Minieskavator, Grejder me targa, Asfaltroshtruese dhe Rul (Kompresor me vibrim),* pasi pa disponimin e këtij numri punonjësish dhe këtyre mjeteve/ automjeteve nuk mund të realizohen punimet objekt kontrate, të cilët duhet të disponojnë dëshmitë e nevojshme për drejtimin e mjeteve të rënda të kërkuara, me qëllim transportimin e materialeve dhe inerteve si dhe gjurmëve për kryerjen e punimeve objekt kontrate, pasi pa këto mjete nuk mund të kryhen punimet objekt kontrate. **Në përcaktimin e numërit të punonjësve shoferë dhe manovratorë, është përcaktuar duke patur parasysh volumin e punimeve që do të kryhen (gërmime, mbushje, rrafshime, shtrimi i shtresave asfaltike, ngjeshja e shtresave etj.) përfshirë dhe transportin e materialeve dhe inerteve, si dhe sasinë dhe llojin e mjeteve që nevojiten për kryerjen e punimeve objekt kontrate,** ku këto punonjës dhe mjete mund të disponohen lehtësisht nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, pasi është lënë mundësia që të mund të sigurohen dhe nëpërmjet qiramarrjes, dhe se në rastin kur ato disponohen me qira, stafi i punonjësve shofer/ manovrator mund të jetë e kontraktuar.

Punonjësit, specialistët, inxhinierët dhe stafi i kualifikuar të kërkuar i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, në rast

se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 në DST, duhet që nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar për t'u paraqitur, të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.10 (Makineri, Pajisje)

a) **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës objekt prokurimi, duhet të disponojë**, automjetet, makineritë dhe pajisjet (**sipas tabelës**) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr.	Përshkrimi i Automjetit/ Makinerisë/ Pajisjes	Sasia
1.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	<i>jo më pak se 2 copë</i>
2.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 - 20 ton	<i>jo më pak se 2 copë</i>
3.	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	<i>jo më pak se 1 copë</i>
4.	Autovinç deri në 5 ton	<i>jo më pak se 1 copë</i>
5.	Eskavator	<i>jo më pak se 6 copë</i>
6.	Rimorkiator për lëvizjen e mjeteve	<i>jo më pak se 1 copë</i>
7.	Fadromë me goma me targa	<i>jo më pak se 3 copë</i>
8.	Minieskavator	<i>jo më pak se 2 copë</i>
9.	Grejder me targa	<i>jo më pak se 3 copë</i>
10.	Autobetoniere	<i>jo më pak se 3 copë</i>
11.	Asfaltroshtruese	<i>jo më pak se 2 copë</i>
12.	Autobitumatrice	<i>jo më pak se 2 copë</i>
13.	Autobot uji	<i>jo më pak se 2 copë</i>
14.	Rul (Kompresor me vibrim)	<i>jo më pak se 2 copë</i>
15.	Makineri për vizime në rrugë	<i>jo më pak se 2 copë</i>
16.	Gazogjen	<i>jo më pak se 1 copë</i>
17.	Betoniere kantieri 0.5 m ³	<i>jo më pak se 2 copë</i>
18.	Vibrator Betoni	<i>jo më pak se 2 copë</i>
19.	Armaturë Kallëperi betoni	<i>jo më pak se 500 m²</i>
20.	Pompë Uji	<i>jo më pak se 2 copë</i>
21.	Matrapik	<i>jo më pak se 2 copë</i>
22.	Gjenerator	<i>jo më pak se 2 copë</i>
23.	Saldatriçe elektrike/ Elektrosaldatriçe	<i>jo më pak se 2 copë</i>
24.	Aparat për kthim dhe prerje hekuri (Tranxhë hekuri)	<i>jo më pak se 1 copë</i>

b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore + Jelekë fosforeshentë – *jo më pak se 85 copë*
- Komplet i ndihmës së shpejtë – *jo më pak se 5 copë*

- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra – *jo më pak se 10 copë*
- Prozhektorë ndriçimi natën – *jo më pak se 5 copë*
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – *jo më pak se 20 copë*

□ **Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të mjeteve/ makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:**

- 1- Për mjetet që shënohen në rregjistra publike duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 2- Për mjetet e siguruar me qira, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 3- Për paisjet/ makineritë në pronësi të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).
- 4- Për paisjet/ makineritë me qera të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).
- 5- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe te pranoje verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- 6- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të deklaruar në procedura prokurimi të tjera për të cilat është shpallur fitues, si dhe nuk janë angazhuara në kontrata të tjera për të cilat nuk kanë përfunduar punimet e zbatimit.

2.3.11 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë 1 (një) “Njësi/ Fabrikë prodhimi Asfaltobetoni” dhe 1 (një) kantier për prodhimin e inerteve në pronësi ose me qera ose me kontratë furnizimi (*Kontrata Noteriale e Qerasë/Furnizimit duhet të ketë kohëzgjatje për gjithë periudhën e realizimit të punimeve objekt kontrate*), ku për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet:

- Dokumentacioni që vërteton pronësinë (*Çertifikatë, Plan-Vendosje & Kartelë e pasurisë*) dhe kontratën noteriale të qerasë/ furnizimit *në rast se kantieri është me qera ose kontratë furnizimi*.

- Leje Mjedisi nga QKL, sipas ligjit në fuqi.
- Dokumentacioni (deklarata) doganore dhe /ose fatura tatimore që vërteton pronësinë e linjës (makineri/pajisje) për prodhim asfaltbetoni dhe inertesh.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.**

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se **operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. **Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”***

Në **nenin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 6/d** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “**6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:...** **d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.**”

1. Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kriteret janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kriteret detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme, njësia e prokurimit vlerëson se **operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë automjetet, mjetet dhe pajisjet e kërkuara me anë të cilave do të kryhen punimet dhe transporti i materialeve sipas zërave të punimeve të përcaktuara në preventivin e specifikimit teknike objekt kontrate**, ku më hollësisht:

- Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton - u referohet analizave 3.211; 3.212/b; 3.222/2; 3.212/a; 3.408;
- Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 - 20 ton - u referohet analizave 3.158/e; 1.132/p; 3.164/1; 3.164/3;
- Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton - kapaciteti i kërkuar i këtyre kamionçinave referohet rrugicave në të cilat do hasen vështirësi nga hyrja e mjeteve të rënda referuar relievit kodrinor ku shtrihen punimet e rrugëve dhe mungesës së infrastrukturës rrugore.

- Autovinç deri në 5 ton - u referohet analizave 3.408; 1.132/p; 3.164/1; 3.169; 3.168 në lidhje me ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve nga kamionat e rënda në kamionçina, dhe pranë vendndodhjes së punimeve përgjatë kanalit, si dhe vendosjen e shtyllave të ndriçimit.
- Eskavator - u referohet analizave 3.158/e; 3.87/b në lidhje me gërmimet dhe ngarkimin e dherave të trupit të rrugës;
- Rimorkiator për lëvizjen e mjeteve – nevojitet për transportin e mjeteve të kërkuara, të cilët nuk mund të qarkullojnë në rrugë si: Eskavator me zinxhir, Asfaltoshtruese etj.
- Fadromë me goma - u referohet analizave 3.164/1b në lidhje me mbushjet e përhapjen me çakëll e gur guroje në trupin e rrugës;
- Minieskavator u referohet analizave 3.158/e; 3.87/b kërkesa për minieskavatorin referohet arsyes për zonat dhe rrugicat e ngushta ku mund të haset vështirësi për eskavarorët e mëdha.
- Grejder me targa - u referohet analizave 3.211; 3.212/b, ku për shkak të relievit dhe mungesës së infrastrukturës së mirfilltë rrugore ka vështirësi në lëvizjen e kamionave.
- Autobetoniere - u referohet analizave 3.245 në lidhje me përzierjen dhe derdhjen e betonit. Kërkesa për numrin e autobetonierëve lidhet me faktin që punimet do kryhen në segmente të ndryshme dhe të garantohet efikasiteti për zbatimin e punimeve
- Asfaltoshtruese - u referohet analizave 3.222/2; 3.212/a në lidhje me shtresat asfaltike dhe të stabilizantit.
- Autobotumatrice - u referohet analizave 3.969/1 në lidhje me spërkatjen me emulsion bituminoz.
- Autobot uji – referuar specifikimeve teknike, kërkohet për transportin e ujit për të kryer përzierjen e betonit dhe proceset e tjera të punës (larje etj.)
- Rul (Kompresor me vibrim) - u referohet analizave 3.164/1b; 3.211; 3.212/b; 3.222/2; 3.212/a për ngjeshjen e shtresave me çakëll dhe asfaltit.
- Makineri për vizime në rrugë - u referohet analizave 3.942 në lidhje me vijëzimin e shiritave gjatësor dhe anësor të rrugëve.
- Gazogjen - u referohet analizave 3.408; 3.169; 3.954; 3.952 në lidhje me kryerjen e procesit të saldimit të tubave metalik dhe vendosjes së shtyllave dhe tabelave rrugore.
- Betoniere kantieri 0.5 m³ - u referohet analizave 1.245 në lidhje me përzierjen e betonit në ato vende/ segmente rrugore ku nuk mund të aksesohet nga autobetonierja/ ose nuk ka nevojë për sasi të madhe betoni.
- Vibrator Betoni - u referohet analizave 1.245 në lidhje me vibrimin e betonit.
- Armaturë Kallëperi betoni - u referohet analizave 1.245 në lidhje me montimin e armaturave ku do të hidhet betoni.
- Pompë Uji - referuar specifikimeve teknike, kërkohet për heqjen e ujit në kanalet kullues e ujrave të bardha të rrugës me qëllim kryerjen e punimeve në to.
- Matrapik - referuar specifikimeve teknike, kërkohet për thyerjen e gurëve/ shkëmbinjve të vegjël gjatë rruhës, ku nuk mund të kryhet gërmimi me mjet tjetër.
- Gjenerator - referuar specifikimeve teknike, kërkohet për sigurimin e furnizimit me energji elektrike të mjeteve/ pajisjeve gjatë kryerjes së punimeve.
- Saldatriçe elektrike/ Elektrosaldatriçe - u referohet analizave 3.408; 3.169; 3.954; 3.952 në lidhje me kryerjen e procesit të saldimit të tubave metalik dhe vendosjes së shtyllave dhe tabelave rrugore.

- Aparat për kthim dhe prerje hekuri (Tranxhë hekuri) - referuar specifikimeve teknike, kërkohet për përpunimin dhe prerjen e hekurit që do të vendoset pwr betonimin në veprat e artit.

ku sasia e tyre është kërkuar në përpjestim me natyrën e përmasat e këtyre punimeve, ku një operator ekonomik pa këto mjete e pajisje nuk mund t'i realizojë këto punimeve. Gjithashtu në zbatim të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”, **njësia e prokurimit ka kërkuar që operatorët ekonomikë duhet të disponojnë dhe pajisjet mbrojtëse për punonjësit të cilët do të angazhohen për kryerjen e punimeve objekt kontrate.** Njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentacionin e nevojshëm që duhet të paraqesin operatorët ekonomik pjesëmarrës me qëllim vërtetimin e disponimit të tyre, dhe dokumentacionin tekniko-ligjor për automjetet të cilat duhet të regjistrohen në regjistrat publik për qarkullimin e tyre, kjo bazuar në dispozitat e neneve për regjistrimin (nenet 92–99) të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, në të cilin përcaktohet se, *mjetet që qarkullojnë në rrugë duhet të jenë të regjistruara dhe të pajisura me targa.*

2. Po ashtu, referuar punimeve objekt prokurimi, njësia e prokurimit vlerëson se, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të vërtetojë disponimin e 1 (një) “Njësi/ Fabrikë prodhimi Asfaltobetonit” dhe 1 (një) kantier për prodhimin e inerteve në pronësi, ose me qera ose me kontratë furnizimi, **pasi kjo i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët janë të aftë të sigurojnë sasinë e nevojshme të materialeve që do të përdoren në investim, si dhe sigurinë e cilësinë të mallrave/ produkteve,** duke qënë se kemi të bëjmë me produkte të cilat duhet të prodhohen nga prodhues të licencuar etj., kërkesë kjo në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës objekt prokurimi, ku në lidhje me përmbushjen e këtij kushti, njësia e prokurimit ka kërkuar paraqitjen e dokumentacionit ligjor në mbështetje të ligjit nr.10 448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” (i ndryshuar), ligjit nr.10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”. Dokumentacioni për përmbushjen e këtij kushti, kërkohet me qëllim vërtetimin se, operatori ekonomik pjesëmarrës disponon vetë (pronësi/ qera) kantierët (inerte/ asfaltobeton), ose ka nënshkruar një kontratë furnizimi me një subjekt i cili disponon vërtet Njësinë/ Fabrikën për prodhimin e Asfaltobetonit dhe kantierin për prodhimin e inerteve, pasi ky është dokumentacioni ligjor që vërteton ekzistencën e Njësisë/ Fabrikës dhe kantierit për prodhimin e inerteve, në rast të kundërt nuk do vërtetohej dot nëse kontratat e furnizimit janë lidhur/ nënshkruar me subjekte të cilët disponojnë këto Njësi/ Kantiere. Paraqitja e dokumentacionit përveç se nuk përbën kosto për operatorin ekonomik pjesëmarrës, por duhet të jetë pjesë dhe e kontratës që nënshkruhet, me qëllim vërtetimin se palët furnizuese janë prodhuese të këtyre mallrave/ materialeve.

2.3.12 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, ditën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë autoritetit kontraktor **një mostër për:**

- **Tabela rrugore treguese dhe të ndryshme** (Sipas specifikime teknike në projekt)

* *Mostrat e paraqitura duhet të jenë prerje ku të evidentohen të gjitha elementet, detajet dhe aksesorët sipas specifikimeve teknike.*

- **Mosdorëzimi i mostrës për secilën pajisje/material të kërkuar ditën e hapjes së ofertave dhe në rast se mostrat nuk janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike e përcaktuara në DST, përbën kusht për s'kualifikim.**

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) **aftësinë teknike dhe profesionale.**

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se **operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. **Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.** 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Në **nenin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 2 dhe 8** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “**2. Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës.**

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Në **nenin 40 pika 6 gërma “a”** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) **mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e***

çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose...”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, referuar materialeve/pajisjeve që do të instalohen në investimin objekt prokurimi, të cilat duhet të jenë sipas standarteve dhe specifikimeve teknike të kërkuara, për shkak të jetëgjatësisë që duhet të kenë si materiale, përtej periudhës së garancisë së punimeve të kërkuar, njësia e prokurimit e vlerëson të rëndësishëm kushtin e paraqitjes së mostrës për këto pajisje/ materiale ditën e hapjes së ofertave, **me qëllim që Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të ketë mundësinë për të kontrolluar nëse këto materiale/pajisje që do të përdoren në realizimin e punimeve objekt kontrate janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit.**

2.3.13 Afati i kryerjes së punimeve:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të firmosur dhe vulosur nga Administratori, të detajuar sipas zërave të preventivit (bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Argumentimi:

Në nenin **15 pika 3/a** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash parashikohet se: “**a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;**”

Njësia e prokurimit referuar të dhënave teknike të projektit, ku parashikohet dhe afati i kryerjes së punimeve bazuar në grafikun e punimeve, vendosi miratimin e afatit të punimeve prej 18 (tetëmbëdhjetë) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, vlerësuar si afat i mjaftueshëm për realizimin e kryerjes së punimeve objekt prokurimi të të gjithë segmenteve rrugore, vlerësuar si afat i mjaftueshëm për realizimin e kryerjes së punimeve objekt prokurimi, ku referuar vlerës dhe natyrës së punimeve që ka ky investim objekt prokurimi, **me qëllim vërtetimin se operatorët ekonomik ofertues kanë paraqitur një ofertë reale, të bazuar në një studim të hollësishëm të projekt - preventivit**, njësia e prokurimit vlerëson se ofertuesit duhet të paraqesin grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

❖ **Argumentimi në lidhje me pikën 2.16/ Seksionin 2 të Njoftimit të Kontratës në dokumentat e tenderit:**

Në zbatim të **nenit 90 pika 6** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Njësia e prokurimit e prokurimit nuk ka lejuar mbështetjen e ofertuesit në kapacitetet e subjekteve të tjera për përmbushjen e kriterëve si më poshtë janë përcaktuar:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:

Ofertuesve nuk u lejohe të mbështeten në kapacitetet e operatorëve të tjerë për plotësimin e kërkesave për kualifikim si më poshtë vijon:

- Vërtetimi i përmbushjes së përvojës së mëparshme në mënyrë të suksesshme kërkuar sipas **pikës 2.3.1/ 2.3 Kapaciteti teknik të KVK, në Dokumentat e Tenderit.**
- Licenca profesionale sipas niveleve për çdo kategori punimesh, kërkuar sipas **pikës 2.3.2/ 2.3 Kapaciteti teknik të KVK, në Dokumentat e Tenderit.**
- Çertifikatat e Cilësisë të kërkuar në **pikën 2.3.3/ 2.3 Kapaciteti teknik të KVK, në Dokumentat e Tenderit.**
- Disponimin e stafit teknik dhe inxhinierik kërkuar në **pikën 2.3.8, gërma “a” dhe “b” / 2.3 Kapaciteti teknik të KVK, në Dokumentat e Tenderit.**
- Disponimin e stafit të punonjësve të specializuar/ kualifikuar të kërkuar në **pikën 2.3.8, gërma “c”/ 2.3 Kapaciteti teknik të KVK, në Dokumentat e Tenderit.**
- Disponimi i mjetet e pajisjet teknike (Asfaltroshtruese, Autobetoniere, Autobitumatrice, Grejder) të kërkuar në **pikën 2.3.10 gërma “a”/ 2.3 Kapaciteti teknik të KVK, në Dokumentat e Tenderit.**

Ofertuesve nuk u lejohe të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, për pikat e sipërcituara pasi vlerësohen kapacitete të lidhura ngushtë me shoqërinë dhe tepër të rëndësishme dhe të nevojshme për të krijuar bindjen te AK se ofertuesit kanë aftësinë për të zbatuar kontratën sipas standardeve të kërkuara.

Referuar sa më lart, Njësia e Prokurimit vlerëson të rëndësishëm faktin e ndalimit të mbështetjes së operatorit ekonomik në kapacitetet e subjekteve të tjera në lidhje me përvojën për punimet e ngjashme, disponimin e kategorive të licencës për zbatimin e punimeve, detyrat që do të ushtrorë stafi inxhinierik, kryerjen e punimeve nga punonjësit e specializuar sipas kualifikimeve të kërkuar, si dhe çertifikimet ISO që lidhen me aftësitë dhe përgjegjshmëritë e ofertuesit, por të përmbushen nga vetë ai, kjo për arsytet se, *investimi objekt prokurimi është një investim i rëndësishëm ku referuar natyrës së tij, atij të rehabilitimit dhe asfaltimit të rrugëve lidhëse në fshtrat e bashkisë Mat*, lind e nevojshme që ofertuesi të vërtetojë se i zotëron realisht dhe në mënyrë të qëndrueshme të gjitha kapacitetet e nevojshme për zbatimin e kontratës, si dhe të angazhojë në mënyrë të plotë të gjithë stafin e kërkuar (inxhinierët dhe punonjësit), pasi në të kundërt nuk mund të garantohet kryerja e këtyre punimeve me cilësi dhe siguri, **ku aftësia profesionale e cila bazohet mbi licencimin e operatorit ekonomik dhe punët që do të kryejnë inxhinierët dhe punonjësit e kualifikuar janë të rëndësishme për vërtetimin se operatori ekonomik është i aftë për realizimin e kontratës objekt prokurimi**, ku mw hollwsisht:

- Përvoja e mëparshme e suksesshme lidhet me aftësinë reale të operatorit për të administruar punime të ngjashme, për të menaxhuar riskun teknik, për të organizuar kantierin, për të respektuar grafikun e punimeve dhe për të realizuar një objekt me cilësi dhe në afat. Në një kontratë pune, përvoja e mëparshme është tregues i drejtpërdrejtë i kapacitetit të vetë operatorit për të marrë përgjegjësi mbi zbatimin. Nëse operatori ekonomik nuk ka vetë përvojën e kërkuar dhe e plotëson atë vetëm nëpërmjet një subjekti të tretë, rrezikohet që kontrata të fitohet nga një subjekt që nuk ka aftësinë e provuar për të menaxhuar objektin, ndërsa subjekti mbështetës mbetet jashtë marrëdhënies kryesore të zbatimit. **Për këtë arsye, kërkesa që përvoja e suksesshme të mos mbulohet me kapacitete të subjekteve të tjera është e lidhur me vetë natyrën e kontratës. Ajo garanton që përgjegjësia dhe aftësia për zbatimin e punimeve të jetë reale dhe e verifikueshme te vetë ofertuesi ose te anëtarët e BOE-së.**
- Licenca profesionale për kategoritë përkatëse të punimeve është kusht thelbësor për ushtrimin e veprimtarisë së ndërtimit. Ajo lidhet me të drejtën dhe aftësinë profesionale për të kryer punimet objekt kontrate. Punimet rrugore, elektrike, ndriçimi, sinjalistika dhe ndërhyrjet infrastrukturore kërkojnë subjekte të licencuara, me përgjegjësi të drejtpërdrejtë teknike dhe ligjore. **Licencat janë aspekt kritik i kontratës dhe Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë që ato të mbulohen nga vetë operatorit ekonomik ose nga anëtarët e BOE-së, të cilët do të jenë palë të drejtpërdrejta në realizimin e kontratës.** Gjithashtu, duhet theksuar se licenca nuk mund të huazohet nga një subjekt tjetër kjo pasi dhe në Vendimin nr.42, datë 16.1.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”* (i ndryshuar), sanksionohet se licencë profesionale është leja për ushtrimin e aktivitetit në fushën e zbatimit të punimeve në ndërtim me të cilin ka detyrimin të pajiset çdo subjekt juridik/ fizik, privat ose publik, që dëshiron të ushtrojë veprimtari në fushën e zbatimit të punimeve në ndërtim dhe plotëson kushtet për t’u pajisur me një të tillë.
- Drejtuesit teknik, stafi inxhinierik dhe punonjësit e kualifikuar janë elementë kyç në zbatimin e një kontrate punimesh. Ata drejtojnë dhe kontrollojnë realizimin teknik të punimeve, cilësinë, respektimin e projektit, sigurinë në kantier, koordinimin e proceseve dhe përputhshmërinë me grafikun. Drejtimi teknik është një nga aspektet më kritike të kontratës. **Mbështetja te një subjekt i tretë për stafin drejtues teknik do të krijonte shkëputje ndërmjet subjektit që fiton kontratën dhe subjektit që realisht ka kapacitetin teknik për ta drejtuar atë.** Kjo do të cenonte kontrollin e Autoritetit Kontraktor mbi përgjegjësinë reale të zbatimit dhe do të krijonte risk që kontrata të administrohej nga një operator pa kapacitet të mjaftueshëm teknik të vetin. Për këtë arsye, kërkesa që drejtuesi teknik dhe stafi inxhinierik të jenë pjesë e kapaciteteve të vetë operatorit ose të anëtarëve të BOE-së është e lidhur drejtpërdrejt me objektin.
- Çertifikatat ISO lidhen me sistemet e menaxhimit të cilësisë, mjedisit, shëndetit, sigurisë në punë, etj. **Në një kontratë punimesh, këto standarde lidhen me mënyrën si operatori ekonomik menaxhon vetë proceset e tij të punës, kontrollin e cilësisë, sigurinë në kantier, ndikimin në mjedis, etj.**
- Mjetet e pajisjet teknike janë gjithashtu element kyç të realizimit të kontratës objekt prokurimi, sidomos ato mjete/ makineri të cilët nevojiten gjatë gjithë kohës së realizimit të punimeve objekt kontrate siç janë: Asfaltroshtuese, Autobetoniere, Autobitumatrice, Grejder, pasi këto mjete në rast do të jenë me mbështetje, nuk vërtetohet fakti se do të jenë prezent gjatë gjithë kohës për kryerjen e punimeve, pasi nuk ka një mekanizëm ligjor që ta detyrojë subjektin mbështetës që

këto mjete/ makineri t'i ketë në çdo kohë në dispozicion të këtij objekti prokurimi, pasi mund t'i ketë angazhuar në kontrata të tjera publike/ private duke riskuar në këtë mënyrë mos përfundimin në kohë të punimeve objekt kontrate. Ku fakt është se, ekziston mundësia që këto mjete të sigurohen dhe me qera, pra, nuk pasjell vështirësi për sigurimin e tyre nga operatorët ekonomik pjesëmarrës.

Gjithashtu, arsyeja tjetër është se, edhe pse pjesëmarrja në procedurat e prokurimit me mbështetje të kapaciteteve në subjekte të tjera, **është një risi e ligjit të ri, pa ndonjë paragjykim, po përdoret në shumë raste nga operatorët ekonomikë vetëm për plotësimin e kërkesave për kualifikim, duke mos i angazhuar de facto stafin teknik dhe punonjësit e marrë me mbështetje në kryerjen e punimeve, mjetet e pajisjet teknike që do të angazhohjë për kryerjen e punimeve duke riskuar në këtë mënyrë realizimin e kontratës.** Moslejimi i mbështetjes në kapacitetet mbështetëse asnjëherë nuk pasjell diskriminimin e operatorëve ekonomik të interesuar, pasi, edhe nëse operatori ekonomik pjesëmarrës/ i interesuar nuk arrin të përmbushë vetë të gjitha kërkesat për kualifikim, ai ka mundësinë e përmbushjes së tyre nëpërmjet bashkimit me operatorë të tjerë ekonomik, **kjo gjithmonë nëse ka dëshirën për të fituar kontratën publike dhe më e rëndësishme vullnetin për të kryer punimet me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.**

Shënim:

Mosdorëzimi i informacionit të saktë apo dorëzimi me të dhëna të rreme, do të konsiderohet kusht për s'kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Në rast se Operatorët Ekonomikë do të paraqesin dokumentacion në gjuhë të huaj, dokumentat duhet të përkthehen në shqip dhe të noterizohen. Përjashtim bën vetëm Katalogu për materialet e kërkuar, i cili mund të jetë dhe në gjuhën Angleze.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në shkresën **Nr.Prot.1974, datë 03.06.2026** “Kërkesë për objektin: “Asfaltim i rrugëve lidhëse në fshatrat e Njësive Administrative Faza II” dërguar nga Sektori i Monitorimit të Kontratave, Hapësirave Rekreative dhe Transportit/ Bashkia Mat, ku bashkëlidhur ka dërguar Projekt – Preventivin, Relacionin, Grafikon e punimeve dhe Specifikimet Teknike përkatëse për punimet objekt prokurimi të kryera nga një shoqëri e licencuar në projektim, duke qënë se specifikimet teknike të dërguara, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit **nr.162/2020, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin publik¹” (i ndryshuar), dhe nenin 39 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për punimet objekt prokurimi.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.
- Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë **data 16.07.2026, ora 10.00, vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al** .

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT